



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1226/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arif Butuc kryetar i subjektit politik KTAP, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mospërputhjes së rezultateve, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Arif Butuc kryetar i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:35 nga Arif Butuc kryetar i KTAP-së, duke pretenduar se sipas rezultateve preliminare nga KQZ-ja (web faqja e KQZ) bartësi i listës Njazi Osmani nga radha e KTAP-së ka marrë 759 vota ndërsa me shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ rezultatet e KTAP-së janë 593 vota dhe nuk ka përputhje të rezultateve për kandidatin Njazi Osmani. Andaj kërkoj që të shqyrtohet rasti i lartpërmendur, thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e Arif Butuc kryetarit të KTAP-së, konstatoi se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur dëshmi bindse ankesës me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1226/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.